

V E N D I M
Nr. 446, datë 25.12.1990

**PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË TOKËS QË U JEPET NË PËRDORIM ME QIRA
PERSONAVE TË HUAJ JURIDIKË E FIZIKË QË USHTROJNË VEPRIMTARI
EKONOMIKE TË PËRBASHKËT NË TERRITORIN E RPSSH**

Në mbështetje të dekretit nr.7437, datë 1.12.1990, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat mesatare për 1 m² tokë që u jepet në përdorim me qira personave të huaj juridikë e fizikë ose shqiptarë me seli jashtë territorit të RPSSH, që ushtrojnë veprimtari ekonomike të përbashkët me ndërmarrjet, kooperativat dhe institucionet tona në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të jetë 20 dollarë në vit.

2. Tarifa për qiranë e tokës caktohet për çdo rast konkret, duke u mbështetur në këto kritere;

- a) pjelloria e tokës dhe vlera e nëntokës;
- b) vendodhja dhe qëllimi i përdorimit të saj;
- c) kushtet klimatike të zonës ku ndodhet;
- ç) kohëzgjatja e shfrytëzimi dhe jetëgjatësia e objektit që ndërtohet.

3. Tarifat konkrete për qiranë e tokës nuk mund të jenë më të ulta se 50 për qind e tarifës mesatare sipas pikës 1 të këtij vendimi.

4. Tarifat konkrete për qiranë e tokës caktohen nga Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, mbi bazën e propozimit të organit epror të ndërmarrjes, kooperativës ose institucionit që ushtrojnë veprimtarinë e përbashkët.

5. Qiraja derdhet në buxhetin e shtetit me këste të barabarta për çdo 3-mujor, sipas afateve që përcaktojnë seksionet e financës të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve ku ndodhet qendra e ndërmarrjes, kooperativës ose institucionit, që ushtron veprimtari të përbashkët.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI